



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

III- Nr. i prot. 2739 Më 07.07.2023
Br. prot. Dt. 07.07.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic
of Kosovo**



**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal
Assembly Rahovec**

**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and
Tourism**

Raporti i punës

Janar–Qershor 2023

Përmbajtja

1. DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM.....	2
2. SPONSORIZIMI I PIKAVE DREJTUAR KUVENDIT KOMUNAL	2
3. SESIONE INFORMUESE.....	2
4. INVESTIMET KAPITALE	3
5. SEKTORI PËR EKONOMI.....	4
5.1. TË HYRAT NË TAKSËN KOMUNALE.....	4
5.2. MENAXHIMI I ASETVE KOMUNALE.....	4
6. SEKTORI PËR ZHVILLIM	4
6.1. TË HYRAT NGA QIRAJA	4
7. ZYRA E QKRB-së.....	4
7.1. TABELA E KËRKESAVE DHE REGJISTRIMI I BIZNESEVE	4
8. SEKTORI I TURIZMIT	5

DATE /A:	07.07.2023
PËR/ZA/TO :	Z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	z.Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për periudhën janar-qershor 2023

1. DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planifikimin e punës për vitin 2023. Në kuadër të DEZHT-së, gjatë kësaj periudhe raportuese, janë realizuar shumë aktivitete.

Në muajin janar, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm kryesisht është fokusuar në inkasimin e borxheve të trashëguara nga viti paraprak në qira dhe në taksa afariste.

Gjatë periudhës janar-mars 2023, është bërë regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2022 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2023, po ashtu është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2023.

2. SPONSORIZIMI I PIKAVE DREJTUAR KUVENDIT KOMUNAL

Gjatë periudhës janar-qershor, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka sponsorizuar disa pika drejtuar Kuvendit Komunal të Rahovecit:

- Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2022.
- Plotësim - ndryshimi i rregullores për taksa komunale 01 Nr. 80/20.
- Shfuqizimi i vendimit për fabrikën e kartonit, si dhe vendimi për dhënie në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit.
- Falja e borxheve të vjetra në taksa afariste për periudhën 01.01.2000 - 31.12.2017.
- Vendimi për dhënien në shfrytëzim përmes ankandit publik të 4 parcelave te Depot e Matreksit në Xërxë. Në këtë ankand ka pasur një aplikant i cili tashmë ka kontratë.
- Vendimi për dhënien në shfrytëzim të lokaleve te palestra "Mizahir Isma", ku në këtë ankand kanë ofertuar dy aplikantë për dy lokale të ndryshme dhe jemi në procedurë të lidhjes së kontratave.

3. SESIONE INFORMUESE

Janë mbajtur 3 sesione informuese:

- ❖ Sesion informues rreth aplikimit për grante në fondet të IPA-s.
- ❖ Sesion informues për grante. Ky sesion informues është organizuar nga Syri Vizion në bashkëpunim me DEZHT-in.

- ❖ Sesion informues për thirrjen e granteve për bizneset, të cilën e ka hapur Ministria e Zhvillimit Rajonal. Ky sesion informues u organizua nga DEZHT-i, në bashkëpunim me Agjencionin Zhvillimor Rajonal.
- ❖ Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), në bashkëpunim me DEZHT-in, ka ndarë 66 kupon me vlerë nga 100 deri në 300 euro për familjet e prekura nga vërshimet, të cilat janë në kushte jo të mira ekonomike.
- ❖ Është mbajtur takimi i dytë i këshillit publiko-privat, ku u diskutuan çështje të ndryshme rreth zhvillimit ekonomik lokal në Rahovec.
- ❖ Në muajin prill, DEZHT ka iniciuar ankandin publik për shitjen e aseteve të papërdorshme të komunës. Përmes këtij ankandi u mundësua shitja e shumë aseteve të cilat nuk janë përdorur për arsye të dëmtimeve dhe të vjetërsisë. Vlera e aseteve të shitura është 12,950.00€.
- ❖ Më datë 27 dhe 28 prill, kemi marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit, i cili u mbajt në Prishtinë. Në këtë panair u prezantuan monumentet e trashëgimisë kulturore, si dhe pikat turistike të komunës së Rahovecit. Në këtë panair, bashkë me ne ishte edhe pronari i bodrumit Kosova Wine.
- ❖ Më datë 15 maj 2023, kemi marrë pjesë në konferencën Diaspora Flet, ku kemi prezantuar projektin e Parkut Industrial në Opterushë, projekt ky i cili do të ndihmojë në rritjen e zhvillimit ekonomik të komunës sonë.
- ❖ Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit me ndërmarrjet private, bashkë me Drejtorin e Bujqësisë z. Berat Duraku, i kemi vizituar 3 biznese të mëdha në Komunën e Rahovecit: Stone Castle, Osa Termosistem dhe Haxhijaha. Në kë vizitë u diskutua mundësia e organizimit të një praktike me pagesë për të rinjtë e komunës sonë. Thirrja është hapur në muajin qershor dhe kanë aplikuar gjithsej 47 aplikantë.

4. INVESTIMET KAPITALE

- Më datë 27.03.2023, ka filluar faza e parë e ndërtimit të Parkut Industrial në Opterushë, projekt ky i cili kap shumën 1,688,216.52€. Për këtë projekt, Komuna e Rahovecit, ka memorandum bashkëpunimi me MINT-in, ku vlera e bashkëfinancimit nga komuna do të jetë 300,000.00€.
- Kanë përfunduar të gjitha punimet në projektin: “Renovimi i shtëpisë së Verërave” dhe jemi në proces të pranimet teknik.
- Kanë vazhduar punimet në projektin: “Rregullimi i Oborrit te Depot e Matreksit në Xërxë” dhe jemi në përfundim të punimeve.
- Ka përfunduar ndërtimi i vrazhdë i projektit: “Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec”, ka përfunduar instalimi elektrik, instalimi ujit dhe tani janë duke u kryer punët me suvatim.

- Kemi përgatitur paramasën për projektin: “Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes në Komunën e Rahovecit”.
- Është duke u përgatitur paramasa për projektin: “Investime në Turizëm”.

5. SEKTORI PËR EKONOMI

Në tremujorin e parë të vitit 2023, janë përgatitur aktvendimet për të gjitha bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale.

5.1. Të hyrat në taksën afariste komunale:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksën afariste për periudhën janar-qershor 2023	36,796.00€

5.2. Menaxhimi i Asteteve komunale

Të gjitha transaksionet në asetet komunale janë të regjistruara me kohë për vitin 2023.

6. SEKTORI PËR ZHVILLIM

Evidenca e të hyrave dhe e ngarkesës së qirasë së lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon Komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Në periudhën janar-qershor 2023, janë lëshuar gjithsej 54 (pesëdhjetë e katër) pëlqime të punës.

6.1. Të hyrat nga qiraja për periudhën janar-qershor është paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiraja për periudhën janar-qershor 2023	39,324.72 €


7. ZYRA E QKRB-së:

- ✦ Evidenca e regjistrimit të bizneseve në Komunën e Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-së, mbahet në mënyrë të rregullt.

7.1. Tabela e kërkesave dhe regjistrimit të bizneseve për periudhën Janar-Qershor 2023

Nr	Përshkrimi	Totali
1	Biznese të reja	83
2	Informata të ndryshme	99
3	Vertetime individuale	17
4	Njësi e re	0
5	Shuarje të biznesit	25
6	N.U.I.	26
7	Ndryshim të tipit nga B.I. në SH.P.K.	03
8	Ndyshimi i emrit tregtar	02
9	Ndërrim i pronarit dhe certifikata të dëmtuara	69

Total kërkesat	324
-----------------------	------------



- Biznese të reja
- Informata të ndryshme
- Vertetime individuale
- Njësi e re
- Shuarje të biznesit
- N.U.I.
- Ndryshim te tipit nga B.I. në SH.P.K.

Kërkesat dhe regjistrimet e bizneseve të shprehura në përqindje

8. SEKTORI I TURIZMIT

Zyra për Informacione Turistike, gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e muajit janar-qershor 2023, si në vijim:

- Janë mbajtur takime të rregullta me organizatën e UNDP-së, në lidhje me projektin për Programin Rajonal 2, ReLoad2.
- Në kuadër të turizmit, është lansuar Harta Turistike Dixhitale në komunën e Rahovecit, ku përmes sistemit CR cod, mundësohet promovimi i atraksioneve turistike dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore. Kjo hartë është e pasuruar me 108 objekte turistike dhe kulturore.

Drejtor i DEZHT-së

Erhan Morina

Erhan Morina

